

# Koordinatori Kombëtar Antitrafik

## Buletin

## Nr. 9

## Informativ

## Janar – Prill 2016

### *Takimi i KRAT Shkodër 7 janar 2016*

Në datën 7 janar 2016 u organizua pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër mbledhja e radhës së KRAT Shkodër.

Në këtë takim u shkëmbyen dhe diskutuan informacione lidhur me analizën vjetore të KRAT Shkodër mbi aktivitetet, rastet e ndjekura dhe situatën aktuale, diskutime pati edhe në lidhje me sukseset por dhe me sfidat në zbatimin e Planit të Veprimit të KRAT 2015 dhe objektivat për vitin 2016 për të përmirësuar veprimtarinë dhe bashkëpunimin midis aktorëve në të ardhmen.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, të Departamentit Amerikan të

Shtetit, përfaqësues nga Caritas Shqipëri, e gjithashtu anëtarët dhe aktorë të përfshirë në tryezat e KRAT nga institucione të ndryshme të përfshira në luftën kundër trafikimit të personave.

•••

### *Dy takime të Autoritetit Përgjegjës gjatë muajit janar 2016 12 janar 2016 – 19 janar 2016*

Gjatë muajit janar 2016 janë organizuar dy takime të Autoritetit Përgjegjës për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të rasteve të identifikuar si viktima e viktima të mundshme trafikimi.

•••

### *Takimi i KRAT Tiranë 15 janar 2016*



Koordinatori Kombëtar në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit të qarkut Tiranë, në datë 15 janar 2016, organizuan takimin e Komitetit Rajonal Antitrafik të Qarkut të Tiranës. Në këtë takim ishin të pranishëm, drejtues të institucioneve shtetërore vendore, si: drejtues të policisë vendore të qarkut, shërbimit social shtetëror, arsimit, shëndetësisë, organizatat që ofrojnë shërbime për njerëzit në nevojë, shoqëria civile, etj. Në fjalën e saj, Zëvendësministria e Punëve të Brendshme e vuri theksin tek koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore dhe organizatave kombëtare dhe lokale në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave. Zj. Gjebrea ftoi

organizatat të bëhen pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të parandalimit, të cilat do të përcaktohen në Planin e Veprimit të Komitetit Rajonal Antitrafik. Bashkëpunimi dhe mirëkoordinimi mes aktorëve antitrafikim është çelësi i suksesit në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave.



Nga ana e tij, prefekti i qarkut, Z. Vorpsi shprehu angazhimin e tij maksimal dhe të institucionit që ai drejton në përpjekjet e të gjithë institucioneve shtetërore dhe joshtetërore në çështjet e trafikimit të personave si dhe vetëm me një angazhim të përbashkët dhe duke unifikuar përpjekjet mund të minimizojmë fenomenin e trafikimit.

Në planin e veprimit për këtë vit, do të punohet më shumë për situatën e fëmijëve në situatë rruge, duke krijuar një sistem më funksional për të lajmëruar në kohë rastet e mundshme të trafikimit nga punonjësit e shkollave, koordinim ndërinstytucional etj.

Gjithashtu u diskutua krijimi i një Task Force nga Drejtoria Arsimore për të rritur rastet e identifikimit dhe raportimit për fëmijë vulnerabël ndaj

trafikimit dhe abuzimit nga trafikantët.

• • •

*Trajnim “Njohja me marrëveshje ndërinstytucionale me objekt parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave. Zbatimi i detyrimeve që lindin nga këto marrëveshje” .  
25 janar 2016*

Më 25 janar 2016, Drejtoria e Antitrafikut në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, organizoi një trajnim me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Tiranë në lidhje me njohjen dhe zbatimin Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Për identifikimin e rasteve të punës dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës së të tjerëve”. Fokusi i trajnimit ishte mënyra e zbatimit në praktikë të marrëveshjeve dhe koordinimi e bashkërendimi me institucionet e tjera për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

• • •

*Trajnime në 12 qarqe të strukturave shtetërore dhe joshtetërore për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e VT/VmT  
Shkurt – prill 2016*



Zyra e Koordinatorit Kombëtar e konsideron ngritjen e kapaciteteve të strukturave antitrafikim një faktor tepër të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit të personave. Në vijimësi janë zhvilluar trajnime dhe workshope për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Vetëm gjatë periudhës shkurt-prill 2016 Zyra e Koordinatorit Kombëtar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit IOM organizoi 12 trajnime në 12 qarqe.

Qëllimi i tyre ishte rritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore në nivel lokal për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave; implementimi korrekt i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin dhe asistencën e viktimave/viktimave të

mundshme të trafikimit (VT/VMT) në nivel lokal.

Ekspertë nga institucionet shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse kanë hartuar një modul trajnimi multidisiplinor për identifikimin dhe referimin tek shërbimet e asistencës të viktimave. Moduli në fjalë po përdoret për trajnimin e punonjësve të zbatimit të ligjit/ofruesve të shërbimeve në 12 qarqet e vendit, ku dhe kryen trajnime në vendin e tyre të punës dhe shpërndanë informacion sipas fushës së tyre të ekspertizës, duke rritur kështu kapacitetet lokale për identifikimin dhe referimin për mbrojtje të VT/VMT.

Këto trajnime u kryen për 480 përfaqësues nga agjencitë publike të zbatimit të ligjit (ku përfshihen strukturat e Policisë Antitrafik; Policisë Kufitare, mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje, Inspektorati Shtetëror i Punës, Shërbimi Social, drejtoritë e shëndetit publik, institucionet arsimore, si dhe organizatat jofitimprurëse).

Pas trajnimeve është hartuar një raport mbi gjetjet dhe rekomandimet që dolën nga trajnimet mbi zbatimin e PSV-ve, të cilat do të reflektohen dhe përfshihen në rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit, proces i cili do të përfundojë deri në fund të vitit 2016.



### Takimi i KRAT Shkodër 5 shkurt 2016

Me datë 5 shkurt 2016, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër është organizuar takimi i radhës i KRAT dhe TT. Qëllimi i këtij takimi ishte vlerësimi i situatës për periudhën janar – dhjetor 2015 në lidhje me numrin e viktimave të trafikimit të identifikuar dhe referuara, trajtimi i rasteve dhe masat e marra, sfidat e hasura dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të informimit dhe sensibilizimit të viktimave të trafikimit në Qarkun Shkodër. Pas një prezantimi të shkurtër të Veprimtarisë së KRAT dhe TT për vitin 2015, u diskutua për përcaktimin e objektivave për vitin 2016. Problematikat e hasura nga anëtarët e KRAT u përcaktuan edhe si objektivat kryesore për vitin 2016. Gjatë këtij viti, në objektivat kryesore do të jenë: Rritja e bashkëpunimit ndërinsitucional për identifikimin e VT dhe VMT, menaxhimin e rasteve dhe riintegrimin e tyre, hartimi i Planit Lokal të Veprimit për

fëmijët në situatë rruge nga Bashkia Shkodër, sigurimi dhe shpërndarja e adresave të kontaktit të drejtuesve të Njësive Administrative dhe Kryepleqve të fshatrave me qëllim ofrimin e ndihmës për ngritjen në kohë dhe menaxhimin e rasteve të VT, sigurimi i ofrimit të trajnuesve të certifikuar për fenomenin e trafikimit të personave nga DAR të cilët do shërbejnë për trajnimin e anëtarëve të KRAT dhe TT, etj.



### Takimi i KRAT Durrës 5 shkurt 2016



Prefekti i Qarkut Durrës, organizoi në datë 5 shkurt 2016 takimin e radhës së KRAT Durrës dhe Tryezës Teknike me teme: Analiza e punës së bërë për vitin 2015 dhe hartimi i Planit të Veprimit për vitin 2016. Në fjalën e tij, Prefekti vuri në dukje rezultatet e arritura në sajë të punës së përbashkët dhe theksoi se për këtë vit duhet forcuar akoma më shumë bashkëpunimi midis strukturave të përfshira në luftën kundër trafikimit të personave dhe të shtrihet veprimtaria e KRAT dhe në zonat më të largëta për të

informuar sa më shumë mbi rrezikun e këtij fenomeni. Diskutimet u karakterizuan nga debatet për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në mënyrë që asnjë nga hallkat e procesit të mos ngelet pa u mbuluar. Diskutime pati dhe për bashkërendimin e Planit të Veprimit në mënyrë që të gjitha aktivitetet të kenë pjesëmarrjen e të gjitha strukturave të nevojshme.

...

### *Takimi i anëtarëve të Task-Forcës së Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Koordinatorit Kombëtar 16 shkurt 2016*



Zhvillohet takimi i parë i Task-Forcës për analizimin e integruar të çështjeve të pushuara dhe mosfilluara të trafikimit të personave, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit.

Task-Forca kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Zj. Elona Gjebrea.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, si dhe ekspertë nga ICITAP, PAMECA dhe OPDAT.

Task-Forca do të punojë për të përmirësuar cilësinë e hetimeve antitrafik dhe rrjedhën e informacionit të përftuar nga përgatitja e mirë dhe sistematike e çështjeve, për të garantuar një qasje multi-institucionale për shqyrtimin e detajuar dhe përmirësimin cilësor të veprimeve antitrafik. Struktura e posaçme do të kryejë analizë të legjislacionit penal mbi çështjet e trafikimit të personave, si dhe do të fokusohet në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë penale.

Rezultatet do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të sistemit dhe të çështjeve individuale në hetimin, ndjekjen penale dhe marrjen e vendimeve për trafikimin e personave, si dhe do të përmirësojnë trajtimin e viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit.

...

### *Takim me shoqërinë civile për problematikat e hasura në zbatimin e protokollit me Kosovën*

### *dhe marrëveshjen me Malin e Zi. 17,26 shkurt, 7 mars 2016*

Në këtë kuadër është hartuar Urdhri i Ministrit nr. 41 datë 15.02.2016 “Për ngritjen e grupit të punës për unifikimin e praktikave, procedurave dhe metodologjisë së punës në drejtim të luftës kundër trafikimit të personave, në zbatim të protokollit shtesë me Kosovën për identifikimin, njoftimin, referimin dhe kthimin e asistuar të VT/VMT”. Më datë 17, 26 shkurt dhe 7 mars 2016, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë organizuar takimet me grupin e punës mbi unifikimin e procedurave mbi protokollin shtesë me Kosovën bazuar në formatet e TRM-së.

U propozua që në takimin që do të organizohet në Kosovë, të prezantohet Udhëzuesi i fëmijëve në situatë rruge dhe në protokoll të përfshihet një seksion për fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu në këto takime u diskutuan shumë detyra lidhur me zbatimin e protokollit si përcaktimi i pikave të kontaktit, zhvillimi sistematik i takimeve në pikat kufitare për zbatimin e protokollit dhe mënyrën e komunikimit, identifikimit dhe kthimit të fëmijëve dhe femrave.

...

*Takime informuese në 9 shkolla të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Tiranës*  
22 shkurt 2016



Zyra e Koordinatorit Kombëtar dhe Policia e Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe organizatat “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, ARSIS dhe Terre des Hommes, organizuan në datë 22 shkurt 2016, disa takime informuese me nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Tiranës. Këto aktivitete ndërgjegjësuere u zhvilluan në 4 shkolla të mesme: “Andon Zako Çajupi”, “Ismail Qemali”, “Aleks Buda” “Myslym Keta” dhe në 5 shkolla 9-vjeçare: “Musine Kokalari”, “Bajram Curri”, “Androkli Kostallari”, “Emin Duraku” dhe “Ahmet Gashi” me pjesëmarrje të nxënësve të klasave 6-9 të ciklit 9-vjeçar dhe 10-12 për arsimin e mesëm. Në takime morën pjesë rreth 370 nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare.

Qëllimi i takimeve ishte:

- Komunikimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve për fenomenin e trafikimit, vendosja e urave të komunikimit me fëmijët, të cilët jo domosdoshmërisht

janë një grup në risk të lartë trafikimi.

- Diskutimi i mënyrave se si vetë fëmijët mund të kontribuojnë në ndërgjegjësimin e bashkëmoshatarëve.
- Mbështetja e bisedave mes nxënësish mbi trafikimin e personave;
- Përcjellja e informacionit tek nxënësit e tjerë.

Përfaqësuesit e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, të policisë së shtetit dhe organizatave jofitimprurëse, informuan nxënësit mbi format e trafikimit, mënyrat dhe treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, asistencë dhe ndihma që iu jepet këtyre viktimave, raportimi me anë të Linjës Kombëtare falas 116 006 dhe Aplikacionit “Raporto! Shpëto!”. Gjatë takimeve u shpërndanë materiale ndërgjegjësuere, si: 160 bluza dhe 200 kapele me numrin e Linjës Kombëtare 116 006 dhe Aplikacionin “Raporto! Shpëto!”, 500 kopje të fotonovelës “Një ëndërr e humbur” dhe 60 kopje cikël temash “Trafikimi i personave” për nxënës të shkollës së mesme dhe studentë.



*Tryezë e rrumbullakët  
“Monitorimi i medias*

*audio vizive mbi raportimin e Trafikimit të Grave dhe Vajzave”*  
23 shkurt 2016



Raportimi në Media i Fenomenit të Trafikimit të Vajzave e Grave ishte në qendër të diskutimit në datë 23 shkurt në tryezën e rrumbullakët, organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UN Women).

Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e UN Women në Shqipëri, Zv. Ministria e Arsimit Zj. Nora Malaj, Zj. Mariana Meshi (presidente e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik) dhe Zj. Valbona Sulçe (eksperte e medias). Në këtë tryezë u fol për rolin kyç dhe partneritetin me median për të luftuar këtë fenomen dhe u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e studimit të fundit për monitorimin e raportimeve të trafikimit në mediat audio-vizive.

Për dy vjet radhazi u ndërmor një proces i monitorimit të medias për të kuptuar se si raportohet fenomeni i trafikimit të vajzave e grave në mediat Shqiptare. Monitorimi i mediave audio-vizive, i cili vjen një vit pas atij

për median e shkruar, nxjerr në pah se pavarësisht përmirësimit të disa treguesve në raportim, në median shqiptare mungojnë njohuritë për fenomenin e trafikimit të vajzave dhe grave.

Monitorimi i medias është pjesë e një programi të përbashkët 2-vjeçar të UN Women financuar nga Bashkimi Evropian, i cili ka kontribuar në rritjen e ndjeshmërisë së medias ndaj fenomenit të trafikimit të personave, ndërgjegjësimin e komunitetit rreth fenomenit, ngritjes së kapaciteteve të aktorëve kyç antitrafikim, si dhe fuqizimin ekonomik të mbijetuarave të trafikimit.

•••

*Takim mbi zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet KK, DPSH dhe ISHPSHS, “Për Procedurat e Bashkëpunimit për Identifikimin e Rasteve të Punës së Detyruar dhe Trafikimit me Qëllim Shfrytëzimin e Punës”*  
25 shkurt 2016

Në Bashkëpunim me OSCE u organizua takimi mbi zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Personave, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së

Shtetit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Për Procedurat e Bashkëpunimit për Identifikimin e Rasteve të Punës së Detyruar dhe Trafikimit me Qëllim Shfrytëzimin e Punës”.

Në këtë takim u diskutua rreth problematikave dhe vështirësive të ndeshura mbi zbatimin në praktikë të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Personave, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Për Procedurat e Bashkëpunimit për Identifikimin e Rasteve të Punës së Detyruar dhe Trafikimit me Qëllim Shfrytëzimin e Punës”, si dhe mbi planifikimin e hapave të mëtejshme në zbatim të këtij Memorandumi

Në këtë takim u ngrit dhe grupi Qendror i Punës dhe forma e shkëmbimit të informacionit.

•••

*Konferenca për prezantimin e Planit të Veprimit për Riintegrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të trafikimit*  
29 shkurt 2016



MPB në bashkëpunim me MMSR, UN Women dhe IOM prezantuan Planin e Veprimit Riintegrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të trafikimit me pjesëmarrjen e 40 përfaqësuesve nga strukturat shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Zëvendësministria Gjebrea gjatë konferencës u shpreh:

*“Zyra e Koordinatorit Kombëtar në bashkëpunim me organizatën IOM për disa muaj kanë zhvilluar takime konsultative me partnerët dhe ka qenë një proces i gjatë, duke reflektuar sugjerimet e të gjithë partnerëve, e gjithë ministrive. 18 kanë qenë institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilët kanë marrë pjesë në këtë draftim të këtij plani veprimi.*

*Plani i Veprimit për Riintegrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të trafikimit ka si qëllim ofrimin e ndihmës, asistencës për riintegrimin e grave dhe vajzave, viktime të mundshme të trafikimit, nëpërmjet hartimit dhe implementimit të politikave ndërsektoriale, duke përfshirë arsimin, punësimin, përfshirjen sociale, mbrojtjen sociale, qëllimin dhe integrimin gjinor, mbrojtjen nga dhuna në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve.*

*Dëshiroj të theksoj që riintegrimi i viktimave të trafikimit është një nga shtyllat kryesore të strategjisë kundër trafikimit të personave, përveç mbrojtjes, dënimit, hetimit penal. Riintegrimi është një shtyllë shumë e rëndësishme, e cila do të ketë dhe vëmendjen e qeverisë shqiptare, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të gjithë partnerëve, me plane e nisma konkrete në dy vitet e ardhshme që përfshijnë fushën e arsimit, të mbrojtjes sociale dhe riintegrimin (apo integrimin gjinor).*

•••

*Prezenca e OSBE-së, Qeveritë Italiane dhe Shqiptare fillojnë projektin e ri për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi  
3 mars 2016*



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ambasada e Republikës së Italisë në Tiranë, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar për Çështje të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, Zj. Elona Gjebra, dhe Kryetaren e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Zj. Ina Verzivolli, më

3 mars 2016, shënuan fillimin e një projekti, i cili ka për synim mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimi dhe migrimi i paligjshëm.



Falë këtij projekti do të fuqizohen kapacitetet e profesionistëve që merren me mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, si dhe do të mundësohen kurse profesionale dhe krijimi i shanseve për punësimin e të rinjve. Projekti ka për synim vendosjen e bashkërendimit të rregullt në nivel vendor për menaxhimin e asistencës për fëmijët viktime dhe viktimat të mundshme të trafikimit; zvogëlimin e risqeve për trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe sigurimin e mbrojtjes dhe asistencës së përshtatshme për fëmijët viktime të trafikimit dhe shfrytëzimit.

Projekti pason punën që ka bërë më herët Prezenca e OSBE-së për trajtimin e fenomenit të punës së të miturve në Shqipëri. Prezenca e OSBE-së i mbështet autoritet qendrore dhe vendore në përvetësimin e një qasjeje shumëdisiplinore e të bazuar në të drejtat e njeriut për parandalimin e trafikimit të personave dhe mbrojtjen e grupeve në rrezik, siç janë fëmijët.

Kjo nismë financohet nga qeveria italiane, me fonde të Bashkëpunimit italian për Zhvillim.

•••

*Workshop dyditor për monitorimin e Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit  
2014-2017  
23-24 mars 2016*



Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në datat 23-24 mars 2016, në ambientet e Hotel Palace në Durrës, organizoi një workshop për monitorimin e Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2014-2017 me përfaqësues të institucioneve anëtare të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë që operojnë në fushën antitrafikim, i cili u facilitua nga ekspertja e IOM, Zj. Hanna Antonova, me një


eksperiencë të konsiderueshme në riintegrimin e viktimave të trafikimit.

Në fund të takimit, pjesëmarrësit draftuan një plan pune për periudhën në vazhdim, i cili do të ndahet me aktorët antitrafikim me qëllim finalizimin e tij.



•••

### *Koordinatori Kombëtar Antitrafik në konferencën e OSBE 11-12 prill 2016*



Më datat 11-12 prill 2016, Zëvendësministria e Punëve të Brendshme Zj. Elona Gjebrea/Koordinatore Kombëtare për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, mori pjesë në Konferencën rajonale me pjesëmarrje nga vende të Evropës dhe Ballkanit, e organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në Vjenë, me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore me qëllim aktivitetin e detyruar kriminal”.

Në konferencë morën pjesë autoritete shtetërore dhe ekspertë të luftës kundër trafikimit të personave, të cilët diskutuan mbi mjetet efikase për të luftuar këtë formë komplekse shfrytëzimi.

Konferenca ishte një forum i shkëlqyer diskutimi mbi gamën e gjerë të aktiviteteve të paligjshme të përfshira në këtë formë shfrytëzimi, sfidat në lidhje me hetimin e veprës penale, identifikimi dhe të drejtat e personave të trafikuar me qëllim shfrytëzimin për aktivitet të detyruar kriminal.

Në fjalën e saj, Zëvendësministria Gjebrea prezantoi arritjet dhe sfidat në luftën kundër trafikimit të personave në Shqipëri, duke theksuar rritjen e mbështetjes shtetërore ndaj shërbimeve shoqërore për personat e trafikuar.

Në lidhje me temën në fokus të konferencës, Zj. Gjebrea shprehu gatishmërinë për reflektimin e kësaj tematike në legjislacionin shqiptar.

•••

### *Takime informuese me nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Vlorës 18 prill 2016*

Ministria e Punëve të Brendshme / Zyra e Koordinatorit Kombëtar,

Policia e Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në datë 18 prill 2016, organizuan 2 takime informuese me nxënës të 6 shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Vlorës.

Aktiviteti i parë u zhvillua me nxënës të klasave të gjashta - të nënta të shkollave 9-vjeçare “Lef Sallata” dhe “Ismail Qemali”, ndërsa aktiviteti i dytë, me nxënës të klasave të dhjeta - të dymbëdhjeta të 4 shkollave të mesme “Ali Demi”, “Mustafa Qemal Ataturk” Jani Minga” dhe “Halim Xhelo”. Në takime morën pjesë rreth 210 nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, si dhe psikologë e mësues të këtyre shkollave. Përfaqësuesi i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, i Drejtorisë së Policisë Vendore të qarkut Vlorë dhe qendrës “Vatra” informuan nxënësit mbi format e trafikimit, mënyrat dhe treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, asistencën dhe ndihmën që iu jepet këtyre viktimave, format e raportimit, sikurse Linja Kombëtare Falas 116 006 dhe Aplikacioni “Raporto! Shpëto!”. Gjithashtu u shkëmbyen mendime dhe u sqaruan pyetjet e drejtuara nga nxënësit dhe psikologët. Gjatë takimeve u shpërndanë materiale ndërgjegjësuese, si: 150 bluza dhe 70 kapele me logon e Linjës Kombëtare



Falas 116 006 dhe Aplikacionin “Raporto! Shpëto!”; 200 kopje të fotonovelës “Një ëndërr e humbur” dhe “Një fillim i ri”; 100 fletëpalosje dhe 60 kopje cikël temash “Trafikimi i personave” për nxënës të shkollës së mesme dhe studentë.

•••

*Takim me anëtarët e KRAT  
dhe TT Vlorë  
18 prill 2016*



Në mjediset e prefekturës së qarkut Vlorë, u zhvillua takimi i radhës i anëtarëve të KRAT dhe TT. Gjatë diskutimeve të pjesëmarrësve u vu theksi më tepër në mënyrën e koordinimit dhe bashkëpunimit mes aktorëve, pasi, sipas tyre, raste të identifikuar janë trajtuar qoftë nga strukturat shtetërore, si policia, shërbimi social apo bashkia, por nuk janë raportuar dhe informuar aktorët e tjerë në Tryezën Teknike. Problematikë, për anëtarët e KRAT dhe TT mbetet ngritja e kapaciteteve të punonjësve, kryesisht mbi detyrimin ligjor që kanë në identifikimin fillestar dhe referimin për viktimat e mundshme të trafikimit, sidomos shërbimi arsimor,

shëndetësor dhe inspektorati i punës. Përfaqësuesi i qendrës “Vatra”, konfirmoi që në periudhën në vijim do të realizojnë trajnime mbi PSV-të me psikologë shkollash, punonjës socialë, përfaqësues të strukturave shtetërore. Drejtorisë Arsimore iu la detyrë që të zhvillojnë më tepër, gjatë orëve edukative, tema mbi trafikimin.

•••

*Bashkëlidhur këtij buletini  
do të gjeni Anex 1, ku janë  
pasqyruar statistikat mbi  
rastet e trafikimit janar-  
prill 2016*

## Anex 1

### Statistika mbi rastet e trafikimit për periudhën janar-prill 2016

☞ Të dhëna statistikore nga Prokuroria për Krime të Rënda

Lloji I trafikimit	Nr. I procedimeve të regjistruara	Nr I procedimeve të çuara për gjykim	Nr I të pandehurve të regjistruar	Nr I të pandehurve të dërguar për gjykim	Çështje të mbartura nga vitet e kaluara
Art. 110/a Trafikimi I personave të rritur	6	1	1	1	38
Art. 128/b Trafikimi I personave të mitur	1	1	5	5	6

☞ Të dhëna statistikore nga sektori kundër trafikëve të paligjshme (Policia e Shtetit)

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Autorë të veprave penale				
			Gjithsej	Masa sigurimi			
				Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lirë	Larguar
1	2	3	4	5	6	7	8
I	KRIME NE FUSHËN E TRAFIQEVE TË PALIGJSHME	129	182	56	5	98	23
1	Trafikimi i personave	21	22	0	3	14	5

2	Trafikimi i te miturve	4	5	0	0	4	1
3	Shfrytëzim Prostitucioni	22	44	27	2	14	1
4	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	5	10	2	0	8	0

⌘ Të dhëna statistikore mbi VT/VmT të identifikuara gjatë periudhës janar-prill 2016

Të dhëna mbi VT/VMT identifikuar gjatë periudhës Janar-Prill 2016	<b>Statusi</b>	
	VT	VMT
	14	9
	<b>Mosha</b>	
	Të rritur	Fëmijë
	13	10
	<b>Seksi</b>	
	M	F
	-	23
	<b>Kombësia</b>	
	Shqiptar	Të huaj
	21	2

☞ Të dhëna statistikore për çështjet penale nga Gjykata e shkallës së parë Për Krime të Rënda

Vepra penale		Dinamika					Të përfunduara				Ankimime				Kërkesa penale			
Neni	Emërtimi i veprës penale	Çështje të mbartura	Të ardhura të reja	Të ardhura pas prishjes	Të ardhura pas	Gjithsej për gjykim	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Pushim vendimi	Mbetur pa përfunduar	Apeli i prokurorit	Apeli i të pandehurit	Rekursi i prokurorit	Rekursi i të pandehurit	Arrest në burg	Arrest shtëpie	Detyrim paraqitje	Arrest në mungesë
110/a /3 KP	Trafikimi i personave	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
110/a /2 KP	Trafikimi i personave	1	1	0	0	2	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
110/a KP	Trafikimi i personave	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
110/a /4 KP	Trafikimi i personave	3	0	0	0	3	2	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0

128/ b/3 KP	Trafiki mi i të miturve, me pasojë vdekje n	2	1	0	0	3	1	0	0	2	0	1	0	0	0	0	0	0
128/ b/1 KP	Trafiki mi i të miturve	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0



---

## Zyra e Koordinatorit Kombëtar

Adresa : Sheshi: "Skënderbej", nr. 3,

Tiranë

Shqipëri

Tel & Faks: 00355 4 223 3540/539

e-mail: [koordinator.kombetar@punetebrendshme.gov.al](mailto:koordinator.kombetar@punetebrendshme.gov.al)

<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/antitrafiku>